

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

TEMA:

*Ndikimi i anksozitetit dhe agresivitetit në korelacionin në mes
suksesit shkollor dhe shkallës së përvetësimit të njohurive
praktike në futboll*

MENTORI:
Dr.Sc. Bylbyl Sokoli

KANDIDATËT:
Arsim Tërshani
Liridon Telaku

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

1. HYRJE-----	3
1.2. HULUMTIMET E DERITANISHME -----	6
3. QËLLIMI I HULUMTIMIT -----	8
4. HIPOTEZAT THEMELORE -----	9
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT-----	10
4.1 MOSTRA E ENTITETIT-----	10
4.2 MOSTRA E VARIJABLAVE -----	10
4.2.1. Variablat bazike-motorike -----	10
4.2.2. Variablat specifike-motorike -----	10
4.2.3. Variablat për vlerësimin e përvetësimit të njohurive teknike janë: -----	11
4.2.4. Variablat për vlerësimin e veçorive konative -----	11
4.2.5. Variablat për vlerësimin e suksesit shkollor -----	11
4.3 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE BAZIKE-MOTORIKE -----	12
4.4. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE SPECIFIKE- MOTORIKE -----	18
2. UDHËHEQJA E TOPIT DREJTVIZOR 40M – MUDT40 -----	19
4.4. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE -----	34
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI -----	35
5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E VARUABLAVE TË APLIKUARA -----	35
5.2. MATRICA E INTERKORELACIONIT -----	61
5.2.1. Matrica e interkorelacionit ndërmjet variablave bazike-motorike -----	61
5.2.2. Matrica e interkorelacionit ndërmjet variablave specifike-motorike -----	62
5.2.3. Matrica e interkorelacionit ndërmjet variablave për përvetësimin e njohurive teknike-----	63
5.2.4. Matrica e interkorelacionit ndërmjet variablave konative dhe suksesit shkollor -----	64
5.3 ANALIZA REGRESIVE E PARAMETRAVE PREDIKTOR DHE KRITERIK -----	65
5.4. HIPOTEZAT THEMELORE -----	71
6. PËRFUNDIMI -----	72
7. LITERATURA -----	74
REZYME-----	76
SUMMARY -----	77

1. HYRJE

Suksesi në lojën e futbollit është i mundur vetëm atëherë nëse në mënyrë sistematike definojnë fenomenet të cilat janë të një rëndësie të veçantë primare për strukturimin e lëvizjeve themelore në lojën e futbollit, ligjshmëritë e transformimeve orientuese dhe gjeneratorët primar të aktiviteteve sportive. Zhvillimi bashkëkohor i futbollit gjithnjë e më tepër bazohet në hulumtimet shkencore dhe qëndrimin kibernetik në modelimin e proceseve të trajningut sportiv. Qëndrimi i tillë kërkon zbulimin e ligjshmërive dhe lidhjeve ndërmjet fushave të ndryshme të statusit psikosomatik të cilat janë përgjegjëse ose veprojnë në ekzekutimin të detyrave të ndryshme motorike në lojën e futbollit. Në kohën e sotme, niveli i arritjes në lojën e futbollit aq është i lartë sa që futbollistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo, rritja e efikasitetit supozohet, jo vetëm rritja e sasisë së punës, por në rend të parë organizimin më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi stërvitor, disa proceseve stërvitore, etapave dhe periudhave, dhe e gjithë kjo pandërprerë duke u kujdesur për gjendjen e futbollistit. Nga aktivitetet polistrukturale komplekse futbollit, përpos që është ndërë sportet më të popullarizuara dhe më atraktive për të gjitha moshat, njëherit është edhe ndër sportet më fitim prurëse në aspektin material. Ky është edhe një motiv shtesë, që të rinjët në numër sa më të madh të kërkojnë të kyqen nëpër shkolla apo klube të futbollit. Dëshira e kyqjes së shteteve ballaknike në unionin evropian hap rrugë edhe më të mëdha për një masovizim të futbollit në këto shtete. Përpos aspektit material që është ndër faktorët e rëndësishëm për rritjen e interesimit të të rinjëve për lojën e futbollit, janë edhe aspektet tjera që ndikojnë në dëshirën e të rinjëve për të luajtur futboll. Lojës së futbollit mund ti përshtaten njerzit e të gjitha gjeneratatve për qëllime të ndryshme si ato shëndetësore, rekreative, garuese, etj., pa marr parasysh zhvillimit të tyre morfologjik, aftësive të tyre motorike, aftësive funksionale apo mundësisë së përshtatjes së njerëzve në shoqëri. Periudha e rritjes dhe zhvillimit të organizmit të të rinjët është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumfishta në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike dhe funksionale. Pikërisht, kjo është arsyeja pse komponent e përbërjes antropologjike duhet të jenë përher në harmoni me kërkesat e lojës së sportit konkret (De Vris, 1976)

Duke pasur parasysh se loja futbollit kërkon një nivel të caktuar të disa karakteristikave antropologjike ashtu që futbollistët e rinj të veprojnë me sukses në situata të ndryshme, dhe në shkencë të ndryshme qasja ndërdisiplinore e studimit e bënë orientimin themelore metodologjikë, lëmia e shkencës në fushën e sportit është statusi antropologjike. Ashtu sikurse egzistojnë specifikat e disa sporteve të cilat janë paraqitur nga diversiteti i strukturës garuese të tyre, ashtu egzistojnë edhe nevoja e vazhdueshme e hulumtimit teorik dhe kontrollit praktik të këtyre specifikave. Aftësitë janë tipare të personalitetit që kontribuojnë në ndryshimet, në performancën e ekzekutimit të aktiviteteve të caktuara me kusht që të egzistojnë përvoja dhe motivimi (Pajevic, 2003). Suksesi i sportistit në aktivitetet fizike varet nga tre grupe faktorësh:

- nga ajo çka mund (i referohet aftësive),
- nga ajo çka din (duke iu referuar nivelit të trajnimit dhe të dijës) dhe
- nga ajo çka don (i referohet motivimit, interesit, vlerave) (Vujmilović, 2012)

Ndonjëherë ndikimi i futbollistëve në të njëjtën lojë është i ndryshëm dhe madje nga një herë edhe për disa herë që në masë të madhe mund ti referohet ndryshimeve në aftësi. Ato definoohen si mundësi potenciale të sportistit për të kryer një aktivitet fizik ose të kryejnë detyrave të caktuara (Pajevic, 2003, 58). Aftësitë e mundshme janë të njohura si predispozitë, dhe të aktualizuara, si njohuri dhe aftësi për llojin e aktiviteteve të caktuara. Për të parashikuar një arritje të veçantë të sportistit në një nga degë sportive, është e rëndësishme të dijm faktorët që ndikojnë në zhvillimin e atyre aftësive dhe nivelin e atyre aftësive. Në grupin e parë përfshihen faktorët trashëgues. Dispozitat që janë të bazuara në strukturat e trashëguar apo gjenetike të sistemit nervor, paraqesin përcaktuesit potencial për zhvillimin e aftësive të caktuara. Përndryshe, mbretrojnë mendimi që trashëgimia përcakton koeficientin e intelegjencës IQ prej mbi 80% (Metikoš, Prot, Holman, Pintar dhe Orebin, 1989). Ky përcaktim është i barabartë ose edhe më të madh se disa aftësi sensorik dhe psikomotorik, kështu që koeficienti i trashëgimis për koordinim, precizitet, drejtpeshim dhe forcë shpërthyesë është rreth 80% dhe për shpejtësi motorike, e cila është aftësia pothuajse tërësisht trashëguese arrin deri në 95% (Metikoš, Prot, Holman, Pintar dhe Orebin, 1989; Malacko, 1986).

Një tjetër faktor që mundëson që potencialet në personalitetin e sportistit të zhvillohen është mjedisi në të cilin jeton sportisti. Këtu para se gjithash mendohet në ndikimin e mjedisit

fizik, mjedisit shoqëror në një kuptim më të gjerë, mundësive ekonomike të shtetit, nivelit të arritur kulturor dhe të ngjajshme. Të gjithë këta faktorë mund të kategorizohen në psikologji në ato që definojnë si mjedisi efikas. Ky është ai mjedis që favorizon zhvillimin e dispozitave të caktuara (Popoviç, 1975, 60).

Faktori i tretë i rëndësishëm është vetaktiviteti me të cilën nënkuptojmë që sportistët investojnë përpjekje për të zhvilluar aftësitë e tyre përmes punës, stërvitjeve dhe të mësuarit. Duke pasur parasysh shpjegimin e dhënë të gjenezës dhe faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e saj, aftësitë mund të përkufizohen si një sistem potencial dinamik për kryerjen e aktiviteteve të caktuara, të fituara përmes aktivitetit në bazë të dispozitave trashëguese dhe nën ndikimin e mjedisit (Pajević, 2003, 59). Në aspektin e hulumtimeve, deri më tani janë kryer studime të shumta me futbollist të niveleve të ndryshme në lidhje me kualitetin dhe kuantitetin e tyre. Kështu, në mesin e hulumtimeve gjenden edhe ato qëllimi i së cilave ishte vërtetimi i karakteristikave morfologjike dhe motorike dhe raporti i tyre në përbërjen e trupit të futbollistët (Matkoviç Mišigoj-Durakovic, Matkoviç, 1998.). Sot në praktikën sportive të procesit të trajnimit zakonisht shfaqen dy mënyra të monitorimit edhe atë e ashtuquajtura kontrolli biologjik dhe procesi i vetë-kontrollit. Por, shumë shpesh aplikohet edhe ndarja e kontrollit të procesit stërvitor në fillim dhe në fund. Prandaj procesi i kontrollit të gjendjes përgatitore dhe përcaktimi nivelit të tij është e orjentuar në përgjithësi në përcaktimin e gjendjes së organizmit të futbollistit i cili dallohet në varësi të kohës së qëndrimit të lodhjes pas tendosjes Zgjedhja dhe identifikimi i talenteve në lojën e futbollit dhe zhvillimi i tyre është një ndër komponentet e rëndësishme të programeve sportive esenciale në shumë shtete të zhvilluara. Në përcaktimin dhe formimin e tipareve antropologjike të një popullate të ndonjë shteti ndikim parësor kanë faktorët gjenetik, por nuk duhet lënë anash ndikimin e faktorëve të jashtëm, pra faktorët ekologjik ose të mjedisit të jashtëm. Vendet e zhvilluara fillojnë shumë herët me seleksionimin dhe përzgjedhjen e një kombëtareje, duke zbatuar planprograme të hartuara nëpërmjet Institutit shtetëror apo në kuadër të Fakultetit përkatës. Hapësira antropologjike është hapësirë shumë dimensionale, interaktive, dhe se për këtë arsye do të përcaktohem që veçanërisht t'i përshkruajmë ato modele teorike të nën hapësirës relevante të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e sukseseve në lojën e futbollit. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapësirë vërehet, se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme.

1.2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Futbolli është padyshim një nga sportet më masovike dhe më të përhapura në botë, dhe deri më tani janë kryer studime të shumta tek lojtarët e futbollit të niveleve të ndryshme në lidhje me cilësinë e tyre. Kështu, në mesin e studimeve të gjerëtanishme gjenden edhe ata qëllimi i të cilave ishte të përcaktimi i karakteristikave morfologjike, motorike dhe situacionale të lojtarëve. Studime të tilla kanë treguar se përbërja e trupit të lojtarëve, përveç që varet nga karakteristikat të tyre individuale, varet edhe nga specifikat e pozitës në të cilën ata luajnë në fushën e futbollit. (Da Silva me bp. 2001., dhe Guerra me bp. 2004.).

- **Klojçnik, A. (1977)**, ka bërë hulumtimme me qëllim që të vërtetohet "Ndikimi i disa sporteve (atletika, volejboli, hendbolli, gjimnastika sportive, basketbolli, futbollit dhe noti) në disa dimensione të statusit psikosomatik dhe ndikimi që paraqitet si diferencë midis sporteve". Hulumtimi është bërë me nxënësit e shkollës fillore prej kl. V - VIII. Mostra e grupit eksperimental ka pasur 795 nxënës, kurse grupi kontrollues 656 nxënës. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar se eksperimenti i mësimit njëvjeçar ka pasur ndryshime të rëndësishme pozitive në statusin psikosomatik në mënyrë specifike. Gjatë përpunimit të rezultateve është aplikuar metoda e analizës univariante të variaciones dhe kovariancës dhe metoda e analizës diskriminuese.
- **Mekić (1984)** në punimin me titull «Ndikimi i karakteristikave morfologjike në shpejtësinë e udhëheqjes precize të topit në futboll» në mostrën e 168 fëmijëve të moshës 13 vjeçare, duke aplikuar analizën regresive me 18 variabla morfologjike dhe 6 teste situacionale të lojës së futbollit ka arritur deri te rezultatet se karakteristikat morfologjike ndikojnë në rezultatet e testeve situacionomotorike për vlerësimin e përvetësimit të lojës së futbollit. Treguesit e masës yndyrore limitojnë rezultatet në testet e analizuara situaciono-motorike.
- **Ganiu, V. (2010)** në punimin e doktoraturës ka hulumtuar karakteristikat morfologjike të futbollistët e rinj të moshës 14 vjeçare në një mostër prej 50 të testuarve (25 futbollistë të rinjë si grupë eksperimental dhe 25 të rinjë si grupë kontrollues) respektivisht dallimin në mes grupit eksperimental dhe kontrollues ku janë aplikuar 14 variabla antropometrike.

- **Elzner, B. (1982).** thekson se forca në sport manifestohet përmes katër formave edhe ato: forca absolute, forca e shpejtësisë, forca eksplozive dhe qëndrueshmëria në forcë. Forca eksplozive është njëri ndër aftësitë më të rëndësishme motorike për futbollistin kulminant.
- **Hadzi&, R. (2000)** ka vërtetuar ndikimin e përgaditjes motorike në rezultatet e testeve situacionale në lojën e futbollit. Studimi u krye në një mostër prej 80 studentëve të vitit të parë të studimeve për edukimin fizik dhe sportiv. Për të përcaktuar ndikimin e gatishmërisë motorike mbi rezultatet e testeve situacionale në futboll është aplikuar analiza e regresionit multiple. Rëndësia teorike e kësaj pune është kryesisht në përcaktimin e ndikimit parcial të gatishmërisë motorike në rezultatet e testeve situacionale të futbollit.
- **Šabotić, B. Drobnjak, D. (2007),** kanë vërtetuar lidhmëninë e variablave prediktore e aftësive baziko-motorike me variablat kriterike të rinjësive të moshës 15 vjeçare në lojën e futbollit.
- **Ibri, L. (2002)** në punimin e magjistraturës ka hulumtuar veçoritë antropometrike dhe motorike të futbollistëve të grupmoshave 14-16 vjeçare. Ka ardhur në përfundim se vlerat antropometrike dhe motorike kanë shkuar në proporcion të drejtë me ligjshmëritë e rritjes dhe zhvillimit.
- **Sokoli, B. (2001)** ka hulumtuar hapësirën antropometrike dhe motorike të 98 futbollistëve 13 vjeçarë dhe ka fituar katër faktorë: 2 faktor antropometrik dhe 2 motorik. Në bazë të këtij hulumtimi studiuesi vjen në përfundim se treguesit antropometrikë, deri diku kanë ndikim të caktuar në parashikimin e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorike, andaj parametrat antropometrik duhet të merren parasysh me rastin e seleksionimit të futbollistëve të rinj.
- **Rexhepi, A. (2013)** në punimin e diplomës Master me titull “ Ndikimi i disa parametrave të volumenit trupor dhe motorik në udhëheqjen e topit në futboll” ka hulumtuar ndikimin e këtyre karakteristikave dhe aftësive antropologjike në udhëheqjen e topit në futboll. Mostar ka përfshirë dy grupe ku grupin e parë (GF) e kanë përbërë 45 futbollist të rinj të gjinisë mashkullore të moshës 14 vjeçare (± 6 muaj), të përfshirë në shkollat e futbollit të Komunës së Prishtinës, dhe grupin e dytë (GN) e kanë përbërë 45 nxënës të gjinisë mashkullore të moshës 14 vjeçare (± 6 muaj). Ka ardhur në përfundim se vlerat grupi i parë ka pas rezultate më të mira në udhëheqjen e topit.

3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i çdo ekipe sportive është rezultati sportiv. Ky rezultat nuk mund të ngritet pa një organizim dhe një punë profesionale. Krahas rezultateve sportive në oragnizmin e futbollistëve të rinj ndodhin ndryshime pozitive në aspektin motorik por edhe në aspektin psikik për shkak të ndikimit të ushtrime sportive, formave të ndryshme të presionit, kërkesave maksimale fizike, gjendjes stresore të cilën e shkakton situata garuese, nevoja për të qenë i rëndësishëm, frika në ndër dije se mund të lëndohet, frika nga konkurenca etj. Të gjitha këto bëjnë që anksoziteti dhe agresiviteti në një mas të thekësuar mund të shfaqen te një numër i konsiderushëm i sportistëve sidomos atyre të moshës së re.

Ndikimi më i madh i ushtrimeve, ligjeratave, bisedave në proceset stërvitore te futbollistët është në moshën më të hershme. Prandaj edhe qëllimi i këtij punimi bazohet në faktin se sa është ndikimi i disa vetive konative (anksozitetit dhe agresivitetit) në ndërlidhje në mes suksesit shkollor dhe përvetësimit, ekzekutimit të elementeve teknike apo të njohurive praktike bazë në lojën e futbollit.

Qëllimi bazik i hulumtimit është i orientuar në vërtetimin e ndikimit të anksozitetit dhe agresivitetit në ndërlidhje në mes suksesit shkollor dhe shkallës së përvetësimit të njohurive praktike në futboll, te futbollistët e rinjë të moshës 14 dhe 15.

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të problemit, lëmisë, qëllimit dhe detyrave të hulumtimit, në harmoni me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e të dhënave janë parashtruara hipotezat:

H₁ – Variablat bazike-motorike, specifike - motorike, testet e përvetësimit të njohurive, anksozitetit dhe agresivitetit si dhe suksesi shkollor të aplikuara në këtë punim nuk do të kenë shmangie nga distribucioni normal.

H₂ – Presim që testet bazike-motorike, specifike - motorike, testet e përvetësimit të njohurive, anksozitetit dhe agresivitetit dhe suksesi shkollor në hapësirën manifeste do të jenë në lidhmëri të rëndësishme statistikore në mes veti.

H₃ – Anksoziteti si faktorë konativ supozojm që kanë ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e testeve bazike-motorike, specifike-motorike dhe përvetësimit të njohurive teknike.

H₄ – Agresiviteti si faktorë konativ supozojm që kanë ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e testeve bazike-motorike, specifike - motorike dhe përvetësimit të njohurive teknike.

H₅ – Supozojm se suksesi në shkollë si faktorë i arritjes akademike ka ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e testeve bazike-motorike, specifike - motorike dhe përvetësimit të njohurive teknike.

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1 MOSTRA E ENTITETIT

Mostra e entiteteve është marrur nga popullata e futbollistëve të rinj (pionier) të klubeve dhe shkollave të futbollit të Komunës së Shtimes dhe Ferizajit. Në hulumtim janë përfshirë 50 futbollist të moshës 14 – 15 vjeçare. Gjatë zgjedhjes së mostrës për këtë hulumtim, është marrë në konsideratë madhësia e mostrës, gadimshmëria e udhëheqësve të shkollave të futbollit dhe trajnerve që punojnë në këto shkolla që të na mundësojnë kushte për realizimin e këtij punimi me karakter hulumtues.

4.2 MOSTRA E VARIJABLAVE

Në këtë hulumtim janë aplikuar gjithsej 25 variabla edhe atë: 6 teste për vlerësimin e aftësive bazike-motorike, 3 teste specifike – motorike, 14 teste për përvetësimin e njohurive teknike, 2 teste konative dhe variabla e suksesit në shkollë.

4.2.1. Variablat bazike-motorike

1. Vrapim 20 m nga starti i lartë.....MV20ML
2. Kërçim nga vendi në gjatësi MKRGJV
3. Kërçimi nga vendi në lartësi MKRLAV
4. Tapingu me këmbëMTAKËM
5. Tetëshja me përkulje.....MTEPËR
6. Hapa anashMHAPAN

4.2.2. Variablat specifike-motorike

1. Udhëheqja e topit sllallom 20mMUST20
2. Udhëheqja e topit drejtvizor 40mMUDT40
3. Goditja e topit në portë nga 16 metra.....MGTP16

4.2.3. Variablat për vlerësimin e përvetësimit të njohurive teknike janë:

1. Zhonglimi i topit me këmbën.....MZHTKË
2. Zhonglimi i topit me gjunjëMZHTGJ
3. Zhonglimi i topit me kokë..MZHTKO
4. Udhëheqja e topit me trinën e plotë.....MUDHTP
5. Udhëheqja e topit me trinën e brendshme.....MUDHTB
6. Udhëheqja e topit me trinën jashtme.....MUDHTJ
7. Pranimi i topit me këmbën e djathtë.....MPRTKD
8. Pranimi i topit me këmbën e majtë.....MPRTKM
9. Pasimi i topit me këmbën e djathtë.....MPATKD
10. Pasimi i topit me këmbën e majtë.....MPATKM
11. Goditja e topit nga vendi me këmbëMGOTVE
12. Goditja e topit në lëvizje me këmbë.....MGOTLE
13. Goditja e topit me kokë.....MGOTKO

4.2.4. Variablat për vlerësimin e veçorive konative

Për hulumtimin e faktorëve patologjik konativë, në këtë punim, janë përdorur ato variabla, që janë aplikuar tashmë disa herë në mostra të ndryshme dhe karakteristikat matëse të të cilëve janë të kënaqëshme për këtë lloj kërkimi.

1. Anksioziteti (ANKSIO) Testi përban gjithsej 80 impulse, ndaj të cilave i anketuari duhet të jep përgjigje, duke rrethuar me shenjën plus (+) nën shenjën sakt, ose jo e sakt (-).

2. Agresiviteti (AGRESI) Testi përban gjithsej 80 impulse, ndaj të cilave i anketuari duhet të jep përgjigje, duke rrethuar me shenjën plus (+) nën shenjën sakt, ose jo e sakt (-).

4.2.5. Variablat për vlerësimin e suksesit shkollor

1. Suksesi shkollor në fund të vitit shkollor kalendarik (SUKSES)

4.3 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE BAZIKE-MOTORIKE

1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20ML

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



Foto 1. Vrapimi 20 metra nga starti i lartë – MV20ML

2. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKRGJV

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë-qëndrimi me këmbë të kthyer në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: E testuara kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.



Foto 2. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJAV

3. Kërcim nga vendi në lartësi – MKRLAV

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit Shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngritë dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , e testuara kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarës: E testuara udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



Foto 3. Kërcim nga vendi në lartësi – MKRLA

4. Tapingu me këmbë – MTAKËM

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës i kufizuar në dimensionet 40 X 40 cm me lartësi 36cm., kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuara ka qëndruar e kthyer me fytyrë kah muri, ku është i shënuar katrori. Pas disa tentimeve provuese, i testuari e ka zgjedhë largësinë e duhur nga katrori i shënuar.

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarit ishte që brenda 15 sek., sa më shpejtë që është e mundur, pa ndërprerje me njëren pastaj këmbën tjetër, të bëjë takime-goditje të dyfishta me pjesën e përparme të shputës. Testi përsëritet tri herë, me pushime të mjaftuara ndërmjet tyre.

Vlerësimi: Llogaritet numri i goditjeve të rregullta me shputë në katrorin e shënuar në kohëzgjatje prej 15 sek.

Udhëzime të testuarës: E testuara udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (i tregohet ngadalë, për goditjet e rregullta dhe ato të parregullta). E testuara bënë disa tentime provuese.



Foto 4. Tapingu me këmbë – MTAKËM

6. Tetëshja me përkulje – MTEPËR

Instrumentet: Kronometri, dy shtylla dhe një litar 5 m i gjatë. Shtyllat vendosen larg njëra-tjetrës në largësi 4 m dhe në to lidhet litari në lartësi të pikës më të lartë të ashtit të legenit të subjektit (lartësia e litarit rregullohet me secilin subjekt veçmas).

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron pranë njëres shtyllë në qëndrim të nisjes së lartë dhe në shenjën “tash”, nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme, duke kaluar nën litar, arrin deri të shtylla tjetër, rrotullohet rreth saj, dhe përsëri vrapon në drejtim të shtyllës tjetër duke u futur nën litar.

Realizimi i detyrës: I testuari nga momenti i dhënies së komandës “tash” ka për detyrë që distancën 4 m ta kalojë 6 herë (ose nga 3 herë duhet të rrotullohet rreth secilës shtyllë).

Vlerësimi: Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu ipen gjatë demonstrimit të detyrës



Foto 5. Tetëshja me përkulje – MTEPËR

7. Hapa anash – MHAPAN

Instrumentet: Kronometri, shirit ngjitës me ngjyrë të dallueshme. Dy pjesë të shiritit të ngjitësit me gjatësi 0.5 m vendosen në dysheme në largësi 4 m paralel njëra me tjetrën.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron afër vijës së nisjes me këmbë të bashkuara, i kthyer tërthorazi me vijën (drejtimin e lëvizjes).

Realizimi i detyrës: I testuari në shenjën “tash” nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme lëviz me hapa-anash, duke mos i kryqëzuar këmbët, deri te vija tjetër, dhe kthehet në anën tjetër duke mos e ndërruar pozitën e trupit. Subjekti duhet që largësinë 4 m ta kalojë 6 herë.

Vlerësimi: Kronometri ndalet kur i testuari me njëren këmbë arrin te vija e nisjes. Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu open gjatë demonstrimit të detyrës.



Foto 6.Hapa anash– MHAPAN

4.4. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE SPECIFIKE- MOTORIKE

1. Udhëheqja e topit sllallom 20m – MUST20

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek, topi i futbollit, pengesa plastike.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës startuese para të cilës qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheq topin gjatësinë e shtegut 20m nëpër pengesa.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

3.



Foto 7. Udhëheqja e topit sllallom – MUST20

2. Udhëheqja e topit drejtvizor 40m – MUDT40

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek, topi i futbollit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës startuese para të cilë qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheq topin gjatësinë e shtegut 40m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



Foto 8. Udhëheqja e topit drejtvizor – MUDT40

3. Goditja e topit në portë nga 16 metra – MGTP16

Instrumentet: Topi i futbollit, porta katrore 1x1m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës për goditjen e topit në drejtim të portës para të cilë qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari ekzekuton pesë goditje në drejtim të portës e cila është katrore 1x1m, nga largësia prej 16

Vlerësimi: Maten golat e shënuar nga ekzekutimi i pesë goditje nga momenti i dhënies së sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari i ekzekuton pesë goditje.

Udhëzime të testuarit: Në rast të shënimeve të dyshimta, jo të rregullt, goditja përsëritet.



Foto 9. Goditja e topit në portë nga 16 metra – MGTP16MG

4.5. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE PËR PËRVETËSIMIN E NJOHURIVE TEKNIKE

1. Zhonglimi i topit me këmbën –MZHTKË

Instrumentet: Topi i futbollit, katrore 2x2m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt brenda vijës për zhonglimi i topit me këmbë.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari ekzekuton zhonglimi i topit me këmbë brenda katrorit 2x2m.

Vlerësimi: Vlerësohet teknika e zhonglimet të topit me këmbën e djathtë dhe të majtë nga momenti i dhënies së sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari gabon ose del nga katrori i caktuar. Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit

Udhëzime të testuarit: të testuarve në fillim të testimit i u ipen udhëzime përkatëse rreth mënyrës së ekzekutimit të testimit. Në rast të gabimeve në fillim testi përsëritet.



Foto 10. Zhonglimi i topit me këmbë– MZHTKË

2. Zhonglimi i topit me gjunjë –MZHTGJ

Instrumentet: Topi i futbollit, katrore 2x2m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt brenda vijës për zhonglimi i topit me gjunjë.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari ekzekuton zhonglimi i topit me gjunjë brenda katrorit 2x2m.

Vlerësimi: Vlerësohet teknika e zhonglimet t topit me këmbën e djathtë dhe të majtë nga momenti i dhënies së sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari gabon ose del nga katrori i caktuar. Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit

Udhëzime të testuarit: të testuarve në fillim të testimit i u ipen udhëzime përkatëse rreth mënyrës së ekzekutimit të testimit. Në rast të gabimeve në fillim testi përsëritet.



Foto 11. Zhonglimi i topit me gjunjë – MZHTGJ

3. Zhonglimi i topit me kokë – MZHTKO

Instrumentet: Topi i futbollit, katrore 2x2m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt brenda vijës për zhonglimi i topit me gjunjë.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari ekzekuton zhonglimi i topit me gjunjë brenda katrorit 2x2m.

Vlerësimi: Vlerësohet teknika e zhonglimet t topit me këmbën e djathtë dhe të majtë nga momenti i dhënies së sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari gabon ose del nga katrori i caktuar. Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit.

Udhëzime të testuarit: të testuarve në fillim të testimit i u ipen udhëzime përkatëse rreth mënyrës së ekzekutimit të testimit. Në rast të gabimeve në fillim testi përsëritet.



Foto 12. Zhonglimi i topit me kokë – MZHTKO

4. Udhëheqja e topit me trinën e plotë – MUDHTP

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 20 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës startuese para të cilë qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheq topin gjatësinë e shtegut me trinën e plotë 20m.

Vlerësimi: Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 13. Udhëheqja e topit me trinën e plotë – MUDHTP

5. Udhëheqja e topit me trinën e brendshme – MUDHTB

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 20 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës startuese para të cilë qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheq topin gjatësinë e shtegut me trinën e brendshme 20m.

Vlerësimi: Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 14. Udhëheqja e topit me trinën e brendshme – MUDHTB

6. Udhëheqja e topit me trinën e jashtme – MUDHTJ

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 20 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejt para vijës startuese para të cilë qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheq topin gjatësinë e shtegut me trinën e jashtme 20m.

Vlerësimi: Vlerësohet ekzekutimi i drejt i teknikës me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, elementi përsëritet



Foto 15. Udhëheqja e topit me trinën e brendshme – MUDHTB

7. Pranimi i topit me këmbën e djathtë – MPRTKD

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 10 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari i parë i cili pranon topin qëndron në pozitë të drejt para vijës së pranimit të topit. Lojtari pasuesi qëndron në pozitë të drejt para vijës së goditjes ose pasimit të topit në largësi prej 10m.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash”, lojtari pasuesi pason topin lojtarit pranues i cili vlerësohet dhe lojtari pranues e pranon topin me këmbën e djathtë.

Vlerësimi: Vlerësohet pranimi i drejt i topit me këmbën e djathtë ose teknika e drejt e pranimit dhe vlerësohet me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga vlerësuesi.

Udhëzime të testuarit: Në rast të pasimit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 15. Pranimi i topit me këmbën e djathtë– MPRTKD

8. Pranimiti i topit me këmbën e majtë – MPRTKM

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 10 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari i parë i cili pranon topin qëndron në pozitë të drejt para vijës së pranimit të topit. Lojtari pasuesi qëndron në pozitë të drejt para vijës së goditjes ose pasimit të topit në largësi prej 10m.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash”, lojtari pasuesi pason topin lojtarit pranues i cili vlerësohet dhe lojtari pranues e pranon topin me këmbën e majtë.

Vlerësimi: Vlerësohet pranimiti i drejt i topit me këmbën e majtë ose teknika e drejt e pranimit dhe vlerësohet me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga vlerësuesi.

Udhëzime të testuarit: Në rast të pasimit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 16. Pranimiti i topit me këmbën e majtë– MPRTKM

9. Pasimi i topit me këmbën e djathtë – MPATKD

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 10 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari i parë i cili pason topin qëndron në pozitë të drejt para vijës së pasimit të topit. Lojtari pranues qëndron në pozitë të drejt me lojtarin pasues i cili pranon topin dhe ja kthen lojtarit pasues për ta përsëritur pasimin në largësi prej 10m.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash”, lojtari pasuesi pason topin lojtarit pranues me këmbën e djathtë i cili e pranon topin dhe ja kthen lojtarit për pasim. Elementi përsëritet tri herë.

Vlerësimi: Vlerësohet pasimi i drejt i topit me këmbën e djathtë ose teknika e drejt e pasimit dhe vlerësohet me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga vlerësuesi.

Udhëzime të testuarit: Në rast të pasimit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 16. Pasimi i topit me këmbën e djathtë – MPATKD

10. Pasimi i topit me këmbën e djathtë – MPATKM

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 10 m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari i parë i cili pason topin qëndron në pozitë të drejt para vijës së pasimit të topit. Lojtari pranues qëndron në pozitë të drejt me lojtarin pasues i cili pranon topin dhe ja kthen lojtarit pasues për ta përsëritur pasimin në largësi prej 10m.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash”, lojtari pasuesi pason topin lojtarit pranues me këmbën e majtë i cili e pranon topin dhe ja kthen lojtarit për pasim. Elementi përsëritet tri herë.

Vlerësimi: Vlerësohet pasimi i drejt i topit me këmbën e majtë ose teknika e drejt e pasimit dhe vlerësohet me notë prej 1-5 nga dhënia e sinjalit nga vlerësuesi.

Udhëzime të testuarit: Në rast të pasimit jo të rregullt, elementi përsëritet.



Foto 16. Pasimi i topit me këmbën e majtë – MPATKM

11. Goditja e topit me këmbën nga vendi – MGOTVE

Instrumentet: Topi i futbollit, distanca 20 m.

Përshkrimi i detyrës:

